



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LAÇ

Nr. 1236 prot.

Laç, më. 14. 07. 2015



KONTRATE PËR MBIKËQYRJE PUNIMESH


Kontratë e lidhur sot me datë 14/07/2015 midis investitorit, Bashkia Laç, përfaqësuar nga z. Artur BARDHI, Kryetar Bashkie dhe Shoqërisë "HE & SK 11" përfaqësuar nga Z. Festim Bregasi, administrator i shoqërisë, me numër liçence MK.2018/7 lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban "Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve zbatimi, një kopje të cilën e mban investitori së bashku me Ekstraktin e Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, për mbikëqyerjen e punimeve për objektin: "Rikonstruksion i kopshtit Nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)".

I – TË PËRGJITHSHME:

Bashkia Laç (Autoritet Kontraktor) ka prokuruar fondin limit 33 839 195 (tridhjetë e tre milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH për "Rikonstruksionin e kopshtit Nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)", duke përcaktuar kontraktuesin që do të kryejë punimet bashkimin e operatorëve ekonomikë **VLLAZNIA NDERTIM I.S SH.P.K. & GJOKA KONSTRUKSION SH.A**, me vlerë 33 700 138 (tridhjetë e tre milion e shtatëqind mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe 40 440 165 (dyzet milion e katërqind e dyzet mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë ME T.V.SH. me të cilin ka lidhur kontratën me datë 14 / 07 / 2015.

Sa më sipër Investitori dhe Mbikëqyrësi përcaktojnë kushtet e kësaj kontrate si më poshtë:

- Mbikëqyrësi i punimeve do ta ushtrojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Udhëzimin Nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr.2, datë.13.05.2005 të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".



2. Mbikëqyrësi i punimeve për objektin në fjalë ka për qëllim kontrollin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve bazuar në K.T.P dhe K.T.Z.
3. Mbikëqyrësi është i detyruar të njohë dhe të veprojë në praktikë konform të gjitha detyrimeve që ka ai nga zbatimi i ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit Nr.3, datë 15.02.2001 i Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Mozbatimi i tyre përbën shkelle dhe mbi të veprojnë sanksionet sipas neneve 15 dhe 16 të ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
4. Në veçanti mbikëqyrësi që të ushtrojë veprimtarinë e tij nuk duhet të ketë asnjë lidhje me zbatuesin e objektit dhe për këtë deklaron me shkrim me përgjegjësi personale para fillimit të punës.





II - TË VEÇANTA

A- Detyrimet e Investitorit

1. Investitori, Bashkia Laç do të bejë pagesën ndaj mbikëqyrësit të punimeve në përfundimin e punimeve të objektit: “Rikonstruksion i kopshtit Nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)”.
2. Investitori detyrohet të paguajë mbikëqyrësin e punimeve në vlerën **558 707** (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatë) lekë pa TVSH dhe **670 449** (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë me TVSH, pasi mbikëqyrësi të ketë plotësuar detyrimet e tij sipas pikës B.

B- Detyrimet e Mbikëqyrësit

1. Mbikëqyrësi i punimeve është një ndër personat kryesorë përgjegjës për ” Rikonstruksionin e kopshtit Nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)”.
2. Mbikëqyrësi mban, kontrollon dhe përgjigjet për dokumentacionin bazë tekniko-ligjor për zbatimin e objektit.
3. Kontrollon plan-organizimin e punimeve si dhe dokumentat për ndryshimet që mund bëhen gjatë punimeve.
4. Kontrollon librin e kantierit dhe përgjigjet për vërtetësinë e dokumentave.
5. Mbledh, harton dhe administron dokumentacionin e nevojshem dhe të domosdoshëm të përcaktuara në dispozitat ligjore të përcaktuara në pikën 1 të kreut 1 të kësaj kontrate.
6. Harton akt supërvizimin dhe me përfundimin e realizimit të punëve të kontraktuara dosjen e inventarizuar ia dorëzon kolauditorit të objektit dhe kopje të saj investitorit.





III - Zgjidhja e mosmarrveshjeve:

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate në rast se nuk do të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë palët i drejtohen Gjykatës.

Pasi palët u njohën me kushtet e kësaj kontrate duke e pranuar të rregullt, e firmosen atë në **3** (tre) kopje.

MBIK ËQYRËSI
HE & SK 11 SH.P.K
DREJTUESI LIGJOR
Festim BREGASI

INVESTITORI
BASHKIA LAÇ
KRYETARI
Artur BARDHI

